



Crna Gora

DECENIJA
OBNOVE
NEZAVISNOSTI
HILJADU GODINA
DRŽAVNOSTI
2016



Da je vječna Crna Gora

KOMISIONI SHITETËROR I ZGJEDHJEVE

DORACAK PËR TRAJNIMIN E KËSHILLAVE ZGJEDHOR

ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË MAL TË ZI 2016

FJALA HYRËSE

Të nderuar anëtarë të këshillave të vendvotimit,

Para jush është doracaku për trajnimin e këshillave zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi, që do të mbahen më 16 tetor 2016.

Ky lloj i „rrugëtimit hap pas hapi“, të cilin e ka përgatitur Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ka për qëllim njoftimin tuaj të përpikët me procedurat e votimit, duke nisur prej përgatitjeve për ditën e votimit e deri te mbyllja e vendvotimit, si dhe me procedurat e numërimit të votave, paketimit dhe transportit të materialit zgjedhor deri te dorëzimi i tij në Komisionin Zgjedhor Komunal.

Doracaku përmban dhe disa norma të caktuara ligjore dhe akte nënligjore që kanë të bëjnë me punën e organeve për realizimin e zgjedhjeve. Krahas përkujtimit në fillim mbi parimet e sistemit zgjedhor,

Manuali fokusohet në detyrimet kryesore të këshillave zgjedhorë dhe procedurat zgjedhore, prej të cilave varet realizimi i njëres nga të drejtat themelore të njeriut – siç është e drejta e votës.

Jam i bindur se ky doracak do t’ju ndihmojë në përgatitjen tuaj cilësore për realizimin e zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen më 16 tetor 2016, në pajtim me legjislacionin shtetëror dhe standardet ndërkombëtare.

Paraprakisht Ju falënderojmë për bashkëpunim.

Budimir Šaranović,

Kryetar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

PËRMBAJTJA

I	FJALA HYRËSE.....	3
II	PASQYRË E SHKURTËR E SISTEMIT ZGJEDHOR PËR vitin 2016	6
III	AKTIVITETET E KËSHILLAVE ZGJEDHORE PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE	6
	a) PRANIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR.....	7
IV	OBLIGIMET KRYESORE TË KËSHILLAVE ZGJEDHORE.....	10
	a) RREGULLIMI I VENDVOTIMIT;.....	11
	b) PERSONAT E AUTORIZUAR PËR PRANI NË VENDVOTIM	13
	c) VËZHGUESIT DHE MEDIA.....	13
V	PROCEDURA E VOTIMIT.....	14
	a) RUAJTJA E RENDIT NË VENDVOTIM DHE MASAT PËR SIGURIMIN E FSHEHTËSISË SË VOTIMIT	21
VI	RREGULLAT E VOTIMIT NËPËRMJET ZARFIT	23
VII	MBYLLJA E VENDVOTIMIT DHE PROCEDURA E NUMËRIMIT.....	26
	a) PËRCAKTIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT	27
	b) PROCESVERBALI PËR PUNËN E KËSHILLIT ZGJEDHOR DHE RAPORTI PËR REZULTATET E ZGJEDHJEVE	28
VIII	PAKETIMI DHE DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NË KKZ.....	28
IX	LISTA E SHTOJCAVE	29

PASQYRË E SHKURTËR E SISTEMIT ZGJEDHOR PËR VITIN 2016

Zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi do të mbahen më 16 tetor 2016. Gjithësej do të zgjidhen 81 anëtarë të Kuvendit, në trupin nacional unik të përfaqësimit, me mandat katërvjeçar sipas sistemit proporcional të ndarjes së mandateve me lista të mbyllura. Lista e kandidatëve që e kapërcejnë pragun prej 3% të votave të vlefshme, merr pjesë në ndarjen e mandateve. Rregullat e posaçme zbatohen për listat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Është e detyrueshme që në lista të jenë minimum 30% të gjinisë që është më pak e përfaqësuar.

Këto zgjedhje do të mbahen sipas kornizës ligjore të ndryshuar. Në mes tjerash, me ndryshimet e Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve të vitit 2014, ka hyrë në fuqi përdorimi i **sistemit të ri për identifikim të zgjedhësve (identifikimi elektronik)**, normat të reja për regjistrimin e kandidatëve dhe ndarja e mandateve për listat e pakicave kombëtare.

AKTIVITETET E KËSHILLAVE ZGJEDHORE PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Kryetari i Këshillit zgjedhor është përgjegjës për funksionimin në tërësi të vendvotimit gjatë ditës së votimit. Por, para fillimit të votimit, ka një varg aktivitete të përgatitore që duhet të ndërmerren nga ana e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillit zgjedhor në mënyrë që procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve të jetë efikas dhe i suksesshëm.

- Përfaqësuesit e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillit zgjedhor kanë për detyrë që më së voni 12 orë përpara fillimit të votimit, të verifikojnë a janë të plotësuar kushtet për votim në vendvotimin përkatës, në pajtueshmëri me kushtet për funksionimin e mjetit për identifikim elektronik të zgjedhësve dhe për këtë bëhet shënimi.
- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe Këshilli zgjedhor, gjatë kontrollit të vendvotimit, kanë për detyrë të verifikojnë se a ka brenda objektit kamera ose pajisje të tjera vëzhgimi dhe të mundësojnë që këto të fiken ose të mbulohen para se të fillojë votimi.

PRANIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Kryetari i Këshillit zgjedhor e merr Materialin zgjedhor nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve më së voni 48 orë para fillimit të votimit. Materiali dhe pajisja i besohen kryetarit të Këshillit të vendvotimit deri në momentin e hapjes së vendvotimit.

MATERIALIN ZGJEDHOR E PËRBËJNË:




1) Kutitë e votimit (2);




2) Lista e kontrollit për verifikimin e kutisë së votuesit



3) Pajisja për identifikimin elektronik të votuesve (EVID) dhe e-Tokeni (2);





4) Fletë votimi;



5) Modeli për fletë votim;




6) Kutia për ruajtjen e kuponit kontrollues dhe vërtetimi - kuponi EIB;

Birakko njekta: (1) LIPETANE

K.R.	Emri	Sex	NUM	Tit	Ballot nr. 13 qita	Proje
					Proje	
1	DANIELI	MAJL	270000110171	1	17.01.1981	17.01.1981
2	MAJL	MAJL	270000110171	2	17.01.1981	17.01.1981
3	MAJL	MAJL	270000110171	3	17.01.1981	17.01.1981
4	MAJL	MAJL	270000110171	4	17.01.1981	17.01.1981
5	MAJL	MAJL	270000110171	5	17.01.1981	17.01.1981
6	MAJL	MAJL	270000110171	6	17.01.1981	17.01.1981
7	MAJL	MAJL	270000110171	7	17.01.1981	17.01.1981
8	MAJL	MAJL	270000110171	8	17.01.1981	17.01.1981
9	MAJL	MAJL	270000110171	9	17.01.1981	17.01.1981
10	MAJL	MAJL	270000110171	10	17.01.1981	17.01.1981


7) Ekstrakti i printuar nga lista e zgjedhësve



8) Procesverbali për punën e Këshillit zgjedhor; 9) Flamuri;




10) Vula, masa mbrojtëse dhe dylli për vulosje;



11) Formulari i kërkesës për votim me zarf;




12) Zarfat;



13) Procesverbali mbi pranimin-dorëzim e materialit zgjedhor



14) Shenjat për vendvotime;



15) Lista përmbledhëse zgjedhore.

OBLIGIMET KRYESORE TË KËSHILLAVE ZGJEDHORE

Si kryetar ose si anëtar i Këshillit zgjedhor, ju jeni njëri nga zyrtarët zgjedhorë me të cilin shumica e zgjedhësve ka kontakt të drejtëpërdrejtë gjatë votimit. Për këtë arsye është shumë me rëndësi që të ruani nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe integritetit gjatë ushtrimit të detyrës, gjatë komunikimit me votuesit në vendvotim. Këtu nënkuptohen dhe detyrat para votimit, siç është ndjekja e trajnimeve dhe përgjegjësia në ditën e votimit, gjatë numërimit të votave dhe raportimit të rezultateve nga vendvotimi.

- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve ka për detyrë që me kohë të përgatisë pajisjen dhe materialin votues për secilin Këshill të vendvotimit, e sidomos: pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve, në të cilën është futur versioni elektronik i ekstraktit nga lista e votuesve, për vendvotimin përkatës; dy e-Tokena (çelësa elektronike) për aktivizimin e pajisjes për identifikim elektronik të votuesve; numrin e duhur të fletëvotimeve; modelin e fletëvotimit (2); listat e përmbledhëse zgjedhore; dy kopje të ekstraktit të Regjistrit të votuesve (njëri është për votim me zarf); kutitë e votimeve në vendvotim; kutinë mobile për votim me zarf; zarfat e posaçëm zyrtarë për votime; si dhe formulari për procesverbal të punës së Këshillit zgjedhor.
- Me rastin e marrjes dhe numërimit të materialit zgjedhor nga alineja 1 e kësaj pike, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe kryetari i Këshillit të vendvotimit do të paketojnë materialin në dosje (përveç pajisjes për identifikim elektronik të votuesve), të cilat sigurohen me dyll të vulosur, me vulën përkatëse. Në dosje konstatohet cili është materiali sipas llojit dhe numrit në dosje. Konstatimin e nënshkruajnë kryetari i Këshillit zgjedhor dhe një anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, i cili bën pranimin e materialit zgjedhor. Nënshkrimet vërtetohen me vulë zyrtare të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.
- Pajisja elektronike për identifikimin e votuesve është e paketuar në kuti të posaçme mbrojtëse. E Tokene që janë të domosdoshme për aktivizimin dhe funksionimin e pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve, me procesverbal e marrin nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve kryetarët e këshillave zgjedhore për secilin vendvotim dhe i paketon ato së bashku me materialet tjera, në pajtueshmëri me udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Për pranimin e dosjes me materialin zgjedhor dhe pajisjes për identifikim elektronik të zgjedhësve hartohet procesverbali mbi pranim/dorëzim, të cilin e nënshkruajnë kryetari i Këshillit zgjedhor dhe përfaqësuesi i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, i cili ka bërë dorëzim/pranimin e materialit (shtojca 1).

RREGULLIMI I VENDVOTIMIT

Këshilli zgjedhor (në përbërje të përhershme dhe përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve që kanë dorëzuar listat zgjedhore) është i obliguar të arrijë në vendvotim në orën 5:00 (dy orë para se të hapen vendvotimet) në ditën e votimeve.

- Hapësirat për votim duhet të jenë mjaft të gjëra për të mundësuar funksionimin e rehatshëm të Këshillit zgjedhor, d.m.th. duhet të ketë mjaft hapësirë në mënyrë që të gjithë anëtarët e Këshillit zgjedhor të mund të shohin pajisjen për identifikim elektronik të votuesve, kutinë e votimit dhe materialin zgjedhor në secilin moment, dhe mjaft hapësirë për vendosjen e kabinave për votim.
- Në hapësirat për votim, një pjesë e veçantë do të jetë e rregulluar për vendosjen e kabinave të votimit, të cilat me formë dhe dimensione duhet ta bëjnë të pamundur të shihet si ka votuar votuesi, dhe të jenë të vendosura ashtu që votuesi gjatë votimit të jetë i kthyer me shpinë nga Këshilli zgjedhor.



- Këshilli zgjedhor do të verifikojë se a është vendosur flamuri i Malit të Zi në vendvotim, a është hapësira ku votohet mjaft e gjërë për lëvizjen e votuesve, a janë të siguruar kushtet për funksionimin e pajisjes për identifikim elektronik të votuesve, a është vendosur kutia e votimit, a ka numër të mjaftueshëm të kabinave-perdeve që mundësojnë votimin e fshehtë, dhe do të sigurojnë që të hiqet çdo lloj materiali që ka të bëjë me fushatën zgjedhore nëse gjendet në vendvotim ose deri në 100 metra afër vendvotimit.
- Pastaj Këshilli zgjedhor do të caktojë me short anëtarin e këshillit me status anëtar të përhershëm, i cili në praninë e anëtarëve të tjerë do të bëjë dëmtimin e dukshëm të vulës, me prerje ose me djegie të pjesës së gomës në bazën e vulës, me të cilën do të vulosen fletëvotimet në anën e kundërt (prapa), në vendin e caktuar dhe kjo vulosje duhet të bëhet pak para se t'i jepet votuesit. Me vulën e dëmtuar nuk vuloset kuponi kontrollues i fletëvotimit..

Vërejtje: Fletëvotimet janë domosdoshmërisht të renditura sipas rendit të numrave serialë në kuponin kontrollues dhe sipas kësaj renditjeje u jepen votuesve gjatë votimit.

- Këshilli Zgjedhor me short e cakton anëtarin e Këshillit i cili e dëmton vulën e Këshillit, anëtarin i cili do të vulosë fletëvotimet dhe anëtarin i cili do të ruajë kuponet kontrolluese mbi fletëverifikimet e identifikimit elektronik të votuesve. Shorti bëhet me sistemin e zarfave të mbyllur, duke i shkruar emrat e anëtarëve të Këshillit, përveç kryetarit, në lista të veçanta dhe t'i vendosin në zarfa të veçantë. Tërheqjen e zarfave e bën kryetari i Këshillit.
- Kryetari i Këshillit i siguron karriget për anëtarët e Këshillit në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar, si dhe numrin e duhur të karrigeve për personat që vëzhgojnë punën e organeve për realizimin e zgjedhjeve.
- Kryetari i Këshillit, në praninë e të gjithë anëtarëve të Këshillit e hapë dosjen me materialin zgjedhor dhe me këtë rast verifikohet se a gjendet aty i tërë materiali nga lista e dosjes.
- Kryetari i Këshillit e hapë kutinë mbrojtëse dhe e vendos pajisjen për identifikim elektronik të votuesve në sipërfaqe të rrafshët (tavolinë) ashtu që shumica e anëtarëve të Këshillit mund ta shohë monitorin e pajisjes dhe e kyç atë në burimin e energjisë elektrike, me çka pajisje vetvetiu vihet në veprim.



Vërejtje: Pas kyçjes së pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve, në monitor/ekran të tij majtas lart paraqitet emri i vendvotimit, në anën e djathtë data dhe koha, kurse në mesin e ekranit mesazhi-informata „kyçeni eToken“.

Priključite eToken.

- Kryetari i këshillit, pas këtyre veprimeve të mëparshme do të pyes anëtarët e këshillit zgjedhor a janë të plotësua tana kushtet për fillim të votimit dhe a kanë vërejtje në ndonjë veprim. Mungesa e vërejtjeve ose vërejtjet dhe emri i anëtarit shënohen në procesverbal për punën e këshillit zgjedhor. (anex 4).

PERSONAT E AUTORIZUAR PËR PRANI NË VENDVOTIM

Prania në vendvotim ditën e votimit lejohet për këta persona:

- Votuesit;
- Anëtarët e Këshillit zgjedhor në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar;
- Vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë të akredituar (me përkthyes)

Sipas nevojë:

- Komisionerët komunalë të zgjedhjeve;
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe zyrtarët e tij;

Opsionale: policët në detyrë nëse thirren për mbajtjen e rendit në vendvotim.

VËZHGESIT DHE MEDIA

Vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve janë me rëndësi për vlerësimin dhe raportimin për transparencën dhe legjitimitetin e zgjedhjeve. Identitetin e tyre e verifikon kryetari i Komisionit në bazë të kartës së identitetit dhe autorizimit zyrtar të dhënë nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kryetari i Këshillit zgjedhor siguron vendin përkatës për të dhe mban evidencë për

vëzhguesit e akredituar (shtojca 6).

Në vendvotim mund të vijnë edhe përfaqësuesit e mediave me qëllim të vëzhgimit të procesit dhe të informimit të opinionit. Vëzhguesit e akredituar dhe përfaqësuesit e mediave janë të mirëseardhur dhe nuk duhet të përjetojnë si ngarkesë.


Vëzhguesit e zgjedhjeve mund të jenë të pranishëm dhe nga afër të ndjekin gjithë procesin e votimit dhe numërimit (me përjashtim të momentit të votimit nga ana e votuesit), derisa nuk pengojnë procesin e votimit dhe numërimit ose nuk ndikojnë gjegjësisht pengojnë përdorimin e materialit në vendvotim.

Vëzhguesit duhet t'i përmbahen normave të posaçme, që të mos pengojnë votuesit në votimin e fshehtë, të mos pengojnë punën e Këshillit zgjedhor si dhe procesin e votimit.


Pasi që fillon procedura e numërimit, vëzhguesit mund të largohen nga vendvotimi, por nuk mund të kthehen dhe të hyjnë në vendvotim pas fillimit të numërimit!

PROCEDURA E VOTIMIT

Në orën 7:00, kryetari i Këshillit zgjedhor e kyç eToken/in në njërin nga dy vendkyçjet e para-para në anën e majtë të pajisjes.



Pasi që personi i autorizuar e kyç eToken/in, në ekran paraqiten këto të dhëna: në këndin e majtë lart, “emri i vendvotimit”, në anën e djathtë “data dhe koha”, nën emrin e vendvotimit shihet numri i votuesve në atë vendvotim për zgjedhjet e caktuara dhe statistika e daljes për atë vendvotim.



Vërejtje: Meqë të njëjtën ditë mund të zhvillohen zgjedhje ndryshme, si p.sh. parlamentare dhe lokale (Andrijevica, Budva, Gucia dhe Kotorri), statistika në ekran tregon të dhënat për secilat zgjedhje veç e veç.

Kryetari i Këshillit zgjedhor e shtyp butonin e printerit me shenjen „Power“, i cili gjendet në anën e majtë të pajisjes (nën monitor).

Në pjesën e poshtme të ekranit gjendet animacioni (foto), i cili shërben si udhëzim se si tërhiqet letërnjoftimi nëpër lexues dhe ajo qëndron aty gjatë gjithë procesit të votimit. Në mënyrë të ngjajshme bëhet dhe “leximi” nga pasaporta, me dallim se fotografia gjendet në anën tjetër.




TË VOTOJË MUNDET VETËM VOTUESI I SHKRUAR NË EKSTRAKTIN E REGJISTRIT TË ZGJEDHËSVE!

Vërejtje: Në praninë e votuesit të parë, për të cilin me anë të tërheqjes së letërnjoftimit ose pasaportës verifikohet se gjendet në Regjistrin e votuesve, Këshilli i vendvotimit kontrollon kutinë e votimit dhe kur konstaton se ajo është e zbrazët, rezultatin e kontrollit e shënon në fletën e kontrollit të cilën e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët tjerë të Këshillit zgjedhor, si dhe votuesi që ka arritur i pari në vendvotim. Fleta e kontrollit futet në kutinë e votimit, e cila në praninë e votuesit të parë, vulolet me garantues dhe dyllin e vulosjes, dhe ky veprim shënohet në procesverbal për punën e Këshillit zgjedhor.

- Votuesi i parë dhe secili pas tij i tregon Këshillit zgjedhor emrin dhe mbiemrin, kurse me letërnjoftimin biometrik ose pasaportë dëshmon identitetin e vet. Me kërkesën e anëtarëve të Këshillit, kryetari i Këshillit ka obligim që dokumentin e identifikimit t’ia tregojë secilit anëtar të Këshillit. Pastaj fillon identifikimi elektronik i votuesit.

Vërejtje: Votuesi i cili refuzon identifikimin elektronik, Këshilli zgjedhor nuk do ta që lejojë të votojë.

- Kryetari i Këshillit zgjedhor tërheq letërnjoftimin biometrik ose pasaportën nëpër lexues në pajisjen për identifikimin elektronik, e gjen votuesin në Regjistrin elektronik të votuesve dhe nëse votuesi gjendet në atë vendvotim, në anën e majtë të ekranit do të paraqitet fotografia e tij, kurse në anën e djathtë të saj emri dhe mbiemri, numri amëz dhe adresa e votuesit. Njëkohësisht me identifikimin elektronik, pajisja do të printojë fletëvërtetimin me përmbajtje: emri dhe mbiemri, numri amëz dhe numrin rendor të votuesit, gjegjësisht identik me atë në Regjistrin zgjedhor të printuar.



Në ekstraktin e printuar nga Regjistri i votuesve, kryetari i Këshillit zgjedhor rrumbullakëson numrin rendor të votuesit të identifikuar, pastaj votuesi nënshkruhet në vendin e paraparë, ndërsa pas kësaj Këshilli zgjedhor i mundëson votuesit të votojë.

- Nëse pajisja për identifikim elektronik të zgjedhësve për ndonjë arsye nuk e printon vërtetimin, kryetari i Këshillit zgjedhor e printon vërtetimin duke shtypur butonin për të përsëritur për printim.



Këshilli zgjedhor e fiton pajisjen elektronike për identifikim të zgjedhësve me letrën për printim të ekstrakteve të vendosur në pajisje. Nëse për ndonjë arsye do të nevojitet të bëhet zëvendësimi i letrës, kjo gjë bëhet në mënyrën e treguar në fotografi.

- Printimi i përsëritur mund të bëhet vetëm nëse votuesi është identifikuar, e nuk ka filluar procesi i identifikimit të votuesit tjetër.
- Kryetari dhe anëtari i Këshillit zgjedhor nga opsionet e kundërta politike, në mënyrë të lexueshme dhe personalisht do të nënshkruajnë në faqen tjetër (pjesën e pasme) ekstraktin e printuar – vërtetimin i cili pastaj do të ruhet në të njëjtën kuti me kuponët kontrollues tek anëtari të cilin e caktoi Këshilli zgjedhor.
- Pas identifikimit të suksesshëm, votuesi do të drejtohet kah anëtari i Këshillit zgjedhor, i cili jep fletëvotimin.
- Anëtari i Këshillit zgjedhor i cili e jep fletëvotimin, është i ulur pranë kryetarit të Këshillit zgjedhor, e vulos fletëvotimin dhe ia jep kryetarit të Këshillit zgjedhor, me ç’gjë sigurohet që votuesit i jepet vetëm një fletëvotim.
- Kryetari i Këshillit zgjedhor i shpjegon votuesit mënyrën e votimit me fjalët që “votuesi voton duke rrumbullakosur numrin rendor pas emrit të listës zgjedhore të cilën e voton, gjegjësisht me rrumbullakimin e emrit të listës ose emrit dhe mbiemrit të bartësit të listës dhe se mund të votojë vetëm një listë zgjedhore nga fletëvotimi”, dhe shpjegon mënyrën e palosjes së fletëvotimit, mbas çkaje votuesin e drejton në kabinë.

Vërejtje: Kryetari i Këshillit zgjedhor është i detyruar që votuesit, me kërkesë të tij, t’ia rishpjegojë procedurën e votimit.

Vërejtje e rëndësishme: Nëse për rrethana të arsyeshme, objektive, siç janë ndërprerja disaorëshe e energjisë elektrike ose prishja në sistem (pajisje), gjatë votimit pamundësohet identifikimi elektronik i votuesit, Këshilli zgjedhor do të sjell vendim që të vazhdojë votimin sipas sistemit të identifikimit vizual. Për marrjen e vendimit që të vazhdojë votimi sipas sistemit të identifikimit vizual, Këshilli zgjedhor njofton Komisionin Komunal të Zgjedhjeve.

- Identifikimi vizual nënkupton që kryetari i Këshillit zgjedhor, me shikimin e letërnjoftimit ose pasaportës të vërtetojë identitetin e votuesit, ta gjejë në Regjistrin zgjedhor të printuar dhe ta rrumbullakojë, t’i mundësojë që të nënshkruhet, të marrë fletëvotimin dhe ta drejtojë në hapësirën për votim. Kur votuesi të votojë, kryetari dhe anëtari i Këshillit zgjedhor nga opsionet e kundërta politike, në mënyrë të lexueshme dhe personalisht e nënshkruajnë kuponin votues-kontrollues në faqen tjetër (pjesa e pasme).
- Identifikimi vizual i votuesit është i obligueshëm shënohet në procesverbal për punën e Këshillit zgjedhor, gjegjësisht në aneksin e tij të posaçëm të shënuar me nr. 1, shtojca 5. Pas përfundimit të arsyes – rrethanave për identifikim vizual të votuesit (rregullimi i pajisjes, furnizimi i rregullt me energji elektrike), Këshilli zgjedhor do të vazhdojë identifikimin elektronik të votuesve, gjë që shënohet në procesverbal.

- Në rastin kur votuesit i është lëshuar letërnjoftimi (ose pasaporta) pas mbylljes së Regjistrit të votuesve, në monitorin e pajisjes për identifikim elektronik do të shfaqen të dhënat e tij, por pjesa e monitorit në të cilin shfaqet fotografia do të jetë e errësuar me mbishkrimin „slika birača nije dostupna” (fotografia e votuesit nuk është e disponueshme). Të dhënat për votuesin të cilat janë shfaqur në monitor duhet të jenë identike me të dhënat në ekstraktin e printuar nga Regjistri zgjedhor. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet Komisionit Komunal të Zgjedhjeve i dorëzon Këshillit zgjedhor (nëse ekzistojnë votues të tillë) regjistrin e zgjedhësve fotografia e të cilëve nuk gjendet në pajisjen për identifikim elektronik për vendvotim.



Votuesi i cili nuk ka mundësi që në vendvotim të votojë personalisht (për shkak të vendvotimit të paaksesueshëm, personi me invaliditet, personi analfabet), ka të drejtë ta bëjë këtë gjë me ndihmën e asistentit të cilin vet e cakton, secili është i detyruar që letrën ta plotësojë, gjegjësisht të votojë në mënyrën në të cilën e urdhëron votuesi.

Votimin për votuesin nga paragrafi i mëparshëm nuk mund ta bëjë anëtari i Këshillit zgjedhor dhe as përfaqësuesi i autorizuar i dorëzuesit të Listës zgjedhore. Mënyra e votimit nga paragrafi i mëparshëm shënohet në procesverbalin e punës së Këshillit zgjedhor.

- Komisioni zgjedhor kompetent ka detyrim që në çdo vendvotim të sigurojë modelin e përshtatshëm i cili i mundëson votuesit me shikim të dëmtuar që të votojë personalisht.
- Këshilli zgjedhor kujdeset që gjatë votimit të personave me invaliditet, të cilët janë shfrytëzues të karrocës, kutia e votimit të vendoset ashtu që lartësia e saj t'i mundësojë hedhjen e fletës së votimit votuesit të tillë.

Vërejtje: Votuesi pas votimit e palos vetë fletën e votimit të plotësuar ashtu që mos të shihet për kënd ka votuar, e që njëkohësisht të mbesë i lirë kuponi kontrollues pas çkaje, duke e mbajtur në dorë fletën e votimit të palosur, shkon deri te kutia e votimit dhe i mundëson anëtarit të Këshillit zgjedhor të përcaktuar me short, e në rast nevojë anëtarit të cilin e cakton Këshilli zgjedhor, që në vend të përcaktuar të ndajë kuponin kontrollues të fletës së votimit. Votuesi pastaj e vendos fletëvotimin në kutinë e duhur të votimit dhe largohet nga vendvotimi.

- Anëtari i Këshillit zgjedhor, i përcaktuar me short, është i obliguar që kuponët e ndarë kontrollues t'i rreshtojë sipas renditjes së numrave serialë dhe së bashku me ekstraktet-vërtetimet e printuara për identifikim elektronik t'i ruajë në kutinë e cila shërben për këtë qëllim.

Vërejtje: Nëse në vendvotim vjen votuesi i cili nuk është i regjistruar në ekstraktin e Regjistrit të votimit për atë vendvotim, me kalimin e dokumentit të tij identifikues nëpër lexues, në ekran të pajisjes për identifikim elektronik nuk do të shfaqet fotografia e tij, e as të dhënat, por në pjesën e poshtme në të majtë të ekranit do të shfaqet informacioni “votuesi nuk është në këtë vendvotim”, ndërsa pajisja nuk e printon ekstraktin – vërtetimin.



- Nëse me rastin e leximit të letërnjoftimit, gjegjësisht pasaportës, vjen deri te gabimi për shkak të kalimit shumë të shpejtë apo shumë të ngadalshëm, lëvizjes së këndit të dokumentit apo papastërtisë së tij, pajisja e detekton këtë lloj gabimi dhe në ekran shfaqet mesazhi në pjesën e poshtme të majtë “gabim gjatë leximit, provojeni përsëri”.



- Kur në vendvotim paraqitet votuesi i cili tashmë është identifikuar, gjegjësisht i cili ka votuar në këtë vendvotim, në rast të tentimit të përsëritur, pajisja për identifikim elektronik nuk lejon printimin e përsëritur të ekstraktit-vërtetimit. Në këtë rast, në ekran shfaqen të dhënat për votuesin dhe fotografia poshtë së cilës qëndron paralajmërimi që votuesi është identifikuar më parë.
- Nëse gjatë punës gabimisht ose për ndonjë arsye tjetër printeri fiket, në ekran në pjesën e poshtme në të majtë do të shfaqet mesazhi “Ju lutemi, ndizni printerin duke përdorur butonin “Power” në printer poshtë ekranit” („molimo vas da upalite štampač koristeći dugme „Power“ na štampaču ispod ekrana“).



Vërejtje: Në rast se nga pajisja për identifikim elektronik nxirret eToken, nuk mund të bëhet identifikimi elektronik, e me rivendosjen e eTokenit pajisja vazhdon me punën e saj.

Vërejtje: Për më shumë informacion shikojeni shtojcën 11.

RUAJTJA E RENDIT NË VENDVOTIM DHE MASAT PËR SIGURIMIN E FSHEHTËSISË SË VOTIMIT

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit zgjedhor kujdesen për punën në vendvotim dhe sigurojnë fshehtësinë e votimit.

- Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit zgjedhor u ndalohet që, në çfarëdo forme, e posaçërisht duke iu drejtuar me zë të deklarojnë emrin dhe mbiemrin e votuesit, si dhe numrin e tij rendor në ekstraktin nga regjistri zgjedhor.

Vërejtje: Në hapësirën e votimit ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike për komunikim (telefon, celular, laptop, tablet, kompjuter etj.).

- Kryetari dhe anëtarët e Këshillit zgjedhor dhe personat të cilët përcjellin punën e organit për mbarëvajtjen e zgjedhjeve janë të detyruar të respektojnë rendin në vendvotim dhe të mos pengojnë punën në vendvotim.

Vërejtje: Anëtarët e Këshillit zgjedhor dhe personat të cilët përcjellin punën e organit për mbarëvajtjen e zgjedhjeve gjatë kohës së votimit, e kanë të ndaluar që në vendvotim të mbajnë çfarëdo lloj evidence për votuesit të cilët kanë votuar, si dhe përdorimin e regjistrit të votimit apo cilësdo evidence tjetër ndihmëse për votuesit.

Vërejtje: Zëvendësit e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit zgjedhor angazhohen në hapësirë për votim vetëm në mungesë të anëtarit të cilin e zëvendësojnë.

Votuesi e plotëson fletëvotimin vetëm në hapësirën e cila është e dedikuar për këtë gjë (kabinë) në mënyrë që mos të shihet si ka votuar.

Vërejtje: Nëse votuesi shkel fshehtësinë e votimit në mënyrë që voton publikisht jashtë hapësirës së caktuar për votim (kabinë), ose nëse pas votimit në hapësirën e cila është e dedikuar për këtë gjë, publikisht ia tregon fletëvotimin Këshillit zgjedhor në mënyrë që të shihet se për ke ka votuar, kryetari i Këshillit zgjedhor, në bazë të vendimit të mëparshëm të Këshillit zgjedhor, është i detyruar që në praninë e Këshillit zgjedhor, pas mënjanimi të kuponit kontrollues, fletëvotimin e tillë ta bëjë të pavlefshëm duke e anuluar, vendosur në zarf të veçantë dhe futur në kuti votimi në vend të votuesit.

Pas votimit, votuesi është i detyruar që menjëherë të largohet nga vendvotimi.

- Këshilli zgjedhor lejon hyrjen në hapësirën e votimit të aq votuesve sa ka kabina, gjegjësisht vende për votim.

- Këshilli zgjedhor do të ndalojë qëndrimin e të gjithë personave në vendvotim të cilët nuk kanë të drejtë dhe detyrim në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, ndërsa kryetari mund të largojë nga vendvotimi çdokënd i cili pengon rendin në vendvotim.
- Përfaqësuesit e policisë dhe personit tjetër në uniformë nuk i lejohej hyrja në vendvotim gjersa vijon votimi.
- Punonjësit e policisë nuk guxojnë të votojnë dhe as të hyjnë në vendvotim me uniformë, përveç në rastin e kërkesës së kryetarit të Këshillit zgjedhor, me qëllim parandalimin e kërcënimit të drejtpërdrejtë të rendit publik dhe të sigurisë në vendvotim.
- Nëse anëtari i Këshillit zgjedhor ose personi i cili e përcjell punën e organit për mbarëvajtjen e zgjedhjeve pengon punën në vendvotim, kryetari i Këshillit zgjedhor do t'ia tërheqë vërejtejen, e nëse personi vazhdon të pengojë punën, kryetari i Këshillit zgjedhor, në bazë të vendimit paraprak të Këshillit zgjedhor, do ta largojë dhe këtë gjë do ta konstatojë në procesverbalin e punës së Këshillit zgjedhor.

Vërejtje: Nëse nga hapësira largohet anëtari i Këshillit zgjedhor, kryetari i Këshillit zgjedhor e ka për detyrim që, për punën e mëtejme, të mundësojë praninë e zëvendësit të tij.

Vërejtje: Nëse në vendvotim prishet rendi, Këshilli zgjedhor mund ta ndërpresë votimin, gjersa rendi të rivendoset. Nëse në vendvotim ftohen përfaqësuesit e policisë, gjatë kohës së pranisë së tyre në vendvotim, votimi ndërpritet. Arsytet e ndërprerjes së votimit shënohen në procesverbalin e punës së Këshillit zgjedhor. Nëse votimi ndërpritet për më shumë se një orë, ai zgjatet për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja.

- Kryetarët e këshillave zgjedhore dhe zëvendësit e tyre, anëtarët dhe zëvendësit e tyre, janë të detyruar që të sillen në pajtim me **Kodeksin e etikës së organeve për mbarëvajtjen e zgjedhjeve (nr. 76/10, të datës 23/12/2010, shiko shtojcën 12)**

RREGULLAT E VOTIMIT NËPËRMJET ZARFIT

Votuesi mund të votojë edhe jashtë vendvotimit në të cilin është i regjistruar në listën e votimit, nëpërmes zarfit, për shkak të:

- moshës,
- invaliditetit
- shërimit spitalor në vendbanim, gjegjësisht shërimit në shtëpi për shkak të sëmundjes së rëndë, dhe
- qëndrimit në institucionin për strehimin e të rriturve-invalidëve dhe personave të moshuar në vendbanim.

Votuesi i cili dëshiron të votojë nëpërmjet zarfit, i dorëzon Këshillit zgjedhor kërkesën për votim nëpërmjet zarfit në formën PP (shtojca 7). Votuesi është i detyruar që ta nënshkruajë vetë formularin.

Kërkesa për votim nëpërmjet zarfit i dorëzohet Këshillit zgjedhor në vendvotim, në të cilin votuesi është i regjistruar në ekstraktin nga lista e votimit, jo më vonë se në orën 13 të ditës së votimit.

- Kërkesën për votim nëpërmjet zarfit mund ta dorëzojë në Këshillin zgjedhor vetëm personi të cilin me nënshkrimin e vet e autorizon dorëzuesi i kërkesës për votim nëpërmjet zarfit. Një person nuk mund të dorëzojë në Këshillin zgjedhor më shumë se një kërkesë për votim nëpërmjet zarfit, përveç në rastin kur këtë gjë e bën për dy ose më shumë votues të cilët votojnë nëpërmjet zarfit, e që jetojnë në bashkësinë e njëjtë familjare.
- Autorizimi për dorëzimin e kërkesës Këshillit zgjedhor për votim nëpërmjet zarfit është pjesë përbërëse e formës së paraparë PP.
- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe këshillat zgjedhore janë të detyruar që personave të cilët dëshirojnë të votojnë nëpërmes zarfit, para zgjedhjeve, gjegjësisht në ditën e zgjedhjeve, t’ia mundësojë formën PP.
- Pas pranimit të kërkesës për votim nëpërmes zarfit, Këshilli zgjedhor kontrollon identitetin e personit – dorëzuesit të kërkesës, vërteton se a është personi i cili dëshiron të votojë nëpërmes zarfit i regjistruar në ekstraktin e printuar nga lista e votuesve dhe vlerëson arsyet nga kërkesa për votim nëpërmes zarfit.
- Këshilli zgjedhor vendos për plotësimin e kushteve për votim nëpërmes zarfit.
- Nëse Këshilli zgjedhor nuk i mundëson ndonjë personi të votojë nëpërmjet zarfit, arsyet për këtë gjë është i detyruar t’i shënojë në procesverbalin e punës së Këshillit zgjedhor (shtojca 9)
- Kur Këshilli zgjedhor vendos që janë plotësuar kushtet që votuesi i cili e ka dorëzuar kërkesën, të votojë nëpërmjet zarfit, kryetari i Këshillit zgjedhor e kalon letërnjoftimin biometrik ose

pasaportën nëpër lexuesin të pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve dhe vendos vërtetimin-ekstraktin e printuar në zarf të veçantë. Kryetari i Këshillit zgjedhor do t'ia dorëzojë letërnjoftimin dhe pasaportën dorëzuesit të kërkesës për votim nëpërmjet zarfit, i cili është i detyruar që dokumentin identifikues t'ia kthejë pa vonesë votuesit – dorëzuesit të kërkesës për votim nëpërmjet zarfit.

- Për çdo votues për të cilin Këshilli zgjedhor vërteton se janë plotësuar kushtet për votim nëpërmjet zarfit, ndahet dhe paketohet: zarfi me fletëvotimin e vërtetuar, zarfi i veçantë me ekstraktin-vërtetimin e printuar për identifikim elektronik, zarfi i veçantë për kuponin kontrollues.
- Nëse, për shkak të rrethanave objektive, të parashikuara me ligj, në vendvotim kryhet identifikimi vizual i votuesit, Këshilli zgjedhor nëpërmjet te besuarit, votuesit i dorëzon materialin e paraparë pa ekstraktin – vërtetimin e printuar për identifikim elektronik të votuesit.
- Pas kalimit të afatit të paraparë për pranim të kërkesave për votim nëpërmjet zarfit dhe pasi që të vërtetohet se cilët votues i plotësojnë kushtet për votim në këtë mënyrë, Këshilli zgjedhor përcakton katër komisionerë për votim nëpërmjet zarfit nga radhët e zëvendësve të anëtarëve të Këshillit zgjedhor. Komisionerët nuk mund të jenë nga radhët e partisë së njëjtë politike apo koalicionit, dhe sipas rregullit përcaktohen dy nga radhët e shumicës qeverisëse dhe dy nga radhët e opozitës.
- Këshilli zgjedhor, te besuarve ju dorëzon: kutinë e tejdukshme mobile për votim nëpërmjet zarfit (të cilën Këshilli zgjedhor, pas kontrollit se a është e rregullt dhe e zbrazët, e vulos); ekstraktin e printuar nga regjistri i votimit; fletëvotimet e vulosura në zarf zyrtar; zarfin me ekstraktet-vërtetimet e printuara për identifikim elektronik të votuesit; listën zgjedhore; zarfa të veçantë për kuponët kontrolluese (shtojca 2); aksesoret për vulosje dhe aksesoret për shkrim.
- Votimin nëpërmjet zarfit mund ta shikojnë edhe vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve në vendvotim.
- I besuari në mënyrë vizuale vërteton identitetin e votuesit – dorëzuesit të kërkesës për votim nëpërmjet zarfit dhe rrethon numrin rendor në ekstraktin e printuar nga lista e votimit, ia jep votuesit fletëvotimin, pranimin e të cilit votuesi e vërteton me nënshkrim personal në ekstraktin nga Regjistri zgjedhor. Votuesi voton e pastaj palon fletëvotimin e plotësuar në mënyrë që mos të shihet si ka votuar, duke e lënë kuponin kontrollues të lirë, të cilin nga fletëvotimi do ta ndajë komisionari dhe e vendos në zarfin e veçantë për kuponët kontrollues, pas kësaj votuesi fletëvotimin e palosur e vendos në kutinë votuese mobile.
- Votuesi i cili nuk ka mundësi të votojë personalisht, ka ta drejtë ta bëjë këtë gjë me ndihmën e personit të cilin ai vetë e cakton dhe i cili është i detyruar që fletëvotimin ta plotësojë, gjegjësisht votimin ta kryejë në mënyrën që e urdhëron votuesi.
- Pasi që votuesi të votojë, të besuarit nënshkruhen personalisht dhe në mënyrë të lexueshme në pjesën e pasme të ekstraktit-vërtetimit të printuar. Vërtetimet-ekstraktet e nënshkruara dhe të printuara vendosen në zarf dhe ruhen bashkë me kuponin kontrollues.
- Nëse për shkak të rrethanave objektive, të parashikuara me ligj, në vendvotim bëhet identifikimi vizual i votuesit, si dhe për votim nëpërmjet zarfit votuesit nuk i dorëzohet ekstrakti-vërtetimi i printuar, të besuarit për votim nëpërmjet zarfit nënshkruhen në mënyrë të lexueshme në pjesën e pasme të kuponit kontrollues.

- Votuesi i cili voton nëpërmjet zarfit, si dhe komisionerët të cilët kryejnë procesin e votimit nëpërmjet zarfit kanë të drejtë të japin vërejtje në mënyrën e votimit dhe punën e të besuarve të cilët regjistrohen në Aneksin 4 të formës PG 21 (Shtojca 10)
- Pasi që e kryejnë procesin e votimit nëpërmjet zarfit, komisionerët ia kthejnë materialin zgjedhor Këshillit zgjedhor.
- Nëse votuesi i cili e ka dorëzuar kërkesën për votim nëpërmjet zarfit refuzon të votojë, komisionerët e paketojnë fletëvotimin e pashfrytëzuar dhe ekstraktin-vërtetimin e printuar në zarf dhe pas përfundimit të procesit të votimit nëpërmjet zarfit, ia kthejnë Këshillit zgjedhor me materialin tjetër.
- Të dhënat që votuesi i cili e ka dorëzuar kërkesën për votim nëpërmjet zarfit nuk ka votuar dhe arsyet për këtë shënohen në procesverbalin e punës së komisionerëve (aneksi 4, forma PG-21).
- Të besuarit ia dorëzojnë Këshillit zgjedhor kutinë votuese portative me fletëvotimet; ekstraktin e printuar nga Regjistri zgjedhor; ndërsa zarfin me kupon kontrollues dhe zarfin me vërtetimet-ekstraktet e printuara për identifikim elektronik të votuesve i dorëzohen anëtarit të Këshillit zgjedhor i cili është i përcaktuar për ruajtjen e kuponëve kontrolluese dhe të vërtetimeve-ekstrakteve.
- Kutinë votuese mobile Këshilli zgjedhor e hap pas mbylljes së vendvotimit dhe vërteton numrin e fletëvotimeve në kutinë portative votuese duke mos cënuar fshehtësinë e votimit.
- Pasi që përcaktohet se votimi nëpërmjet zarfit është kryer në përputhje me rregullat, Këshilli zgjedhor fletëvotimet që ndodhen në kutinë votuese mobile për votim nëpërmjet zarfit i përzien me fletëvotimet që ndodhen në kutinë e votimit në vendvotim, dhe vetëm pastaj fillon përcaktimi i rezultateve të votimit në vendvotim.
- Në procesverbalin për punën e Këshillit zgjedhor shënohet: numri i kërkesave të pranuar për votim nëpërmjet zarfit, numri i votuesve të cilëve Këshilli zgjedhor iu ka mundësuar votimin nëpërmjet zarfit dhe numri i votuesve të cilët kanë votuar nëpërmjet zarfit, si dhe vërejtjet, gjegjësisht mospasja e vërejtjeve në procesin e votimit.
- Kërkesat për votim nëpërmjet zarfit të dorëzuara në Këshillin zgjedhor dhe ekstraktin nga lista e votuesve për votim nëpërmjet zarfit, Këshilli zgjedhor i vendos në zarf të veçantë, në të cilin është e shënuar shenja e përmbajtjes, i cili pas përcaktimit të rezultateve të votimit, vulozet dhe i dorëzohet Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, si pjesë përbërëse e materialit zgjedhor.

MBYLLJA E VENDVOTIMIT DHE PROCEDURA E NUMËRIMIT

Vendvotimi mbyllet në orën 20:00. Votuesve të cilët gjenden në vendvotim në momentin e mbylljes së vendvotimit, do t'u mundësohet të votojnë, ndërsa Këshilli zgjedhor paraprakisht përcakton numrin dhe identitetin e këtyre votuesve duke ju marrur dokumentet identifikuese.

- Në orën 20:00, në ekran poshtë animacionit do të shfaqet opsioni “Statistika”. Përdorimi i opsionit “Statistika” nuk është i detyrueshëm. Ky opsion shërben që pas votimit mund të printohet raporti statistikor i cili përmban këto të dhëna: vendvotimin, datën dhe kohën e printimit, numrin e votuesve në vendvotim sipas llojit të përzgjedhjes, numrin e votuesve të identifikuar, numrin e votuesve për të cilët është tentuar identifikimi i përsëritur, numri i votuesve për të cilët është tentuar identifikimi e të cilët nuk ndodhen në ekstraktin e Regjistrit të votimit për vendvotim.



Vërejtje: Opsioni “Statistika” mund të inicohet, pas vendimit të Këshillit zgjedhor dhe vetëm pas kalimit të kohës së paraparë për votim dhe nëse në pajisjen elektronike për identifikim të votuesve janë të kyçur të dy eTokenat.

PËRCAKTIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT

Me mbylljen e vendvotimit, kryetari i Këshillit zgjedhor i pyet anëtarët e Këshillit zgjedhor nëse kanë vërejtje mbi vijueshmërinë e votimit. Mosekzistencën e vërejtjeve apo ekzistencën e tyre, përfshirë përmbajtjen dhe emrin e personit që ka dhënë vërejtje e shënon në procesverbalin për punën e Këshillit zgjedhor (shtojca 4).

- Në procesverbal shënohet edhe informata se a ka vërejtje në punën e komisionerëve për votim nëpërmjet zarfit.
- Pas përfundimit të votimit, Këshilli zgjedhor fillon përcaktimin e rezultateve të votimit në vendvotim.
- Këshilli zgjedhor përcakton numrin e fletëvotimeve të papërdorura dhe i vendos në zarf të veçantë, i cili vulolet me shenjën e përmbajtjes.
- Këshilli zgjedhor e verifikon numrin e kuponëve kontrolluese të ndara nga fletëvotimet dhe numrin e ekstrakteve-vërtetimeve të printuara për identifikim elektronik të votuesve dhe i vendos ndaras në mbështjellësit e veçantë të cilët vulolet, me shenjën e përmbajtjes.
- Në bazë të ekstraktit të printuar nga lista e votimit, Këshilli zgjedhor përcakton numrin e përgjithshëm të votuesve që kanë votuar. Numri i përgjithshëm fitohet me mbledhjen e numrit të votuesve të rrumbullakuar në ekstraktin e printuar nga lista e votuesve i Këshillit zgjedhor dhe ekstraktin e printuar nga lista e votuesve për votuesit që kanë votuar nëpërmjet zarfit.
- Të dhënat lidhur me fletëvotimet e papërdorura, numrin e kuponëve kontrolluese të ndara nga fletëvotimet, numrin e ekstrakteve-vërtetimeve të printuara për identifikim elektronik të votuesve, dhe numrin e përgjithshëm të votuesve të cilët kanë votuar, Këshilli zgjedhor i shënon në procesverbal para hapjes së kutisë së votimit.
- Kur kutia e votimit hapet, futen fletët nga kutia portative për votim nëpërmjet zarfit. Pas kontrollit të listës kontrolluese, fletëvotimet e vlefshme ndahen nga të pavlefshmet.
- Këshilli zgjedhor përcakton numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, pastaj numrin e fletëvotimeve të vlefshme, si dhe numrin e votave për çdo listë zgjedhore, gjë që shënohet në procesverbal.
- Fletëvotimi i pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, fleta e cila është e plotësuar në atë mënyrë që nuk mund të përcaktohet për cilën listë zgjedhore është votuar dhe fletëvotimi në të cilin është rrumbullakuar më shumë se një listë zgjedhore.
- Fletëvotimet e papërdorura, të pavlefshme dhe të vlefshme, Këshilli zgjedhor i vendos në mbështjellës të veçantë, në të cilët qëndron shenja e përmbajtjes dhe të cilët vulolet.
- Materialet tjera zgjedhore (procesverbali i punës, ekstrakti nga Regjistri i votimit, fletëvotimet, kuponët kontrolluese të ndara nga fletëvotimet, vërtetime-ekstraktet, kërkesat për votim nëpërmjet zarfit, vula e Këshillit zgjedhor, si dhe materiali i mbetur zgjedhor) vendoset në një zarf i cili vulolet.
- Pajisja elektronike për identifikimin e votuesve pakëtohet në kutinë e veçantë mbrojtëse.

Pas përcaktimit të rezultateve të votimit, Këshilli zgjedhor, pa zvarritje, e më së voni në afat prej gjashtë orësh nga mbyllja e vendvotimit, materialin zgjedhor dhe pajisjet ia dorëzon Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.

PROCESVERBALI PËR PUNËN E KËSHILLIT ZGJEDHOR DHE RAPORTI PËR REZULTATET E ZGJEDHJEVE

Procesverbali për punën e Këshillit zgjedhor përpilohet në formën e paraparë, i cili i dorëzohet Këshillit zgjedhor (shtojca 4).

- Procesverbali për punën e Këshillit zgjedhor përmban të dhënat për personat të cilët kanë përcjellur punën e Këshillit zgjedhor dhe për kohën e qëndrimit të tyre në vendvotim. Të dhënat në procesverbal i shënon kryetari i Këshillit zgjedhor.
- Kryetari i Këshillit zgjedhor është i obliguar që vërejtjen e anëtarit të Këshillit zgjedhor ta vendosë në procesverbal në momentin e dhënies së vërejtjes.
- Procesverbalin për punën e Këshillit zgjedhor e nënshkruan kryetari dhe anëtarët e Këshillit zgjedhor.

Vërejtje: Nëse ndonjëri prej anëtarëve të Këshillit zgjedhor refuzon të nënshkruajë procesverbalin, kryetari i Këshillit zgjedhor do ta pyes për arsyet e refuzimit. Arsyeja e refuzimit të nënshkrimit të procesverbalit dhe arsyeja që procesverbali nuk është nënshkruar për arsye se anëtari i Këshillit zgjedhor më herët është larguar nga vendvotimi, shënohet në procesverbal në formë të konstatimit në fund të tij, gjë që e nënshkruajnë anëtarët e pranishëm të Këshillit zgjedhor.

- Nga një kopje të procesverbalit kryetari i Këshillit zgjedhor ua dorëzon anëtarëve të Këshillit zgjedhor. Pjesë përbërëse e procesverbalit për punën e Këshillit zgjedhor janë formularet-aneksat e procesverbalit, të cilat i përcakton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (shtojcat 5,6,7,8,9,10).

PAKETIMI DHE DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NË KKZ

- Kryetari i Këshillit zgjedhor dhe dy përfaqësuesit e autorizuar të listave zgjedhore të cilët kanë fituar numrin më të madh të votave në vendvotim, ia dorëzojnë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve materialin zgjedhor dhe pajisjet e vulosura.
- Kryetari i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve sjellësit të materialit zgjedhor ia lëshon vërtetimin për pranimin e materialit dhe pajisjeve zgjedhore.

LISTA E SHTOJCAVE:

- Shtojca 1: Procesverbali i pranim-dorëzimit të materialit;
- Shtojca 2: Procesverbali i pranim-dorëzimit të materialit zgjedhor për votim me zarf/postë;
- Shtojca 3: Lista kontrolluese për verifikimin e kutive të votimit;
- Shtojca 4: Procesverbali për punën e Këshillit zgjedhor;
- Shtojca 5: Procesverbali mbi ecurinë e votimit;
- Shtojca 6: Evidenca mbi vëzhguesit e akredituar;
- Shtojca 7: Kërkesa për votim me zarf;
- Shtojca 8: Shkaqet se pse Këshilli zgjedhor nuk i ka mundur zgjedhësin të votojë me zarf;
- Shtojca 9: Komisioni për votim me zarf;
- Shtojca 10: Vërejtjet e anëtarëve të Këshillit të vendvotimit;
- Shtojca 11: Udhëzimet mbi përdorimin e pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve;
- Shtojca 12: Kodeksi etik i organeve për realizimin e zgjedhjeve.

PROCESVERBAL
MBI PRANIMIN - DORËZIM E MATERIALIT ZGJEDHOR

Këshilli zgjedhor për vendvotimin -----

(Emri i komunës, numri dhe emri i vendvotimit)

Ka marrë nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve _____ dita _____

(emri i komunës)

(data)

viti, këto materiale zgjedhore:

1. ekstrakt nga Regjistri zgjedhor _____

(numri)

2. Kutitë e votimit _____

(numri)

3. Kutitë mobile të _____

(numri)

4. Kuti për kuponat e kontrollit _____

(numri)

5. Pajisja elektronike për identifikimin e votuesve dhe dy eTokena _____

(numri)

6. Lista e kontrollit për verifikimin e kutive të votimit.

7. Fletëvotime _____

(numri)

8. Modele për fletëvotime _____

(numri)

9. Procesverbali i punës së Këshillit të vendvotimit _____

10. Listat gjithëpërfshirëse zgjedhore për deputetë – këshilltarë _____

(numri)

11. Zarfat për votim _____

(numri)

12. Zarfat zyrtarë për votim _____

(numri)

13. Vula e Këshillit zgjedhor

14. Flamuri i Malit të ZI

15. Materialet tjera zgjedhore (pajisje për vulosje, letërngjitës etj.)

(të shënohen dhe pajisjet tjera dhe materialet që ka pranuar Këshilli i vendvotimit)

Dorëzoi në emër të Komisionit zgjedhor Pranoi - kryetari i Këshillit të vendvotimit

(emri dhe mbiemri)

(emri dhe mbiemri)

SHËNIM: Për votimet që zhvillohen paralel (parlamentare, lokale etj.), dorëzohen po aq ekstrakte nga Regjistri i votuesve sa palë votime ka atë ditë.

PROCËVERBALI
MBI DORËZIMIN E MATERIALIT ZGJEDHOR PËR VOTIM ME ZARF

Komisioneri i autorizuar për votim me zarf për vendvotimin
(emri i komunës, numri dhe emri i vendvotimit)

Kanë marrë nga Këshilli i vendvotimit _____ dita _____
(emri i Këshillit të vendvotimit) (data)

viti, këto materiale zgjedhore:

1. Ekstraktin nga lista e votuesve
2. Kutia mobile e votimit
3. Zarfat për kuponat e kontrollit dhe fletëvërtetimet _____ (numri)
4. Fletëvotime _____ (numri)
5. Modelet për fletëvotime _____ (numri)
6. Listat gjithëpërfshirëse zgjedhore për deputetë - këshilltarë
7. Materialet tjera zgjedhore (pajisje për vulosje, letërngjitës etj.)

(të shënohen dhe pajisjet tjera dhe materialet që ka pranuar Këshilli i vendvotimit)

Dorëzoi kryetari i Këshillit zgjedhor

Pranuan – të autorizuarit:

1. _____
(emri dhe mbiemri)

2. _____
(emri dhe mbiemri)

3. _____
(emri dhe mbiemri)

4. _____
(emri dhe mbiemri)

FLETA E KONTROLLIT PËR VERIFIKIMIN E KUTISË SË VOTIMIT

Këshilli i vendvotimit për vendvotimin _____
(emri i komunës, numri rendor dhe emri i vendvotimit)

Ka bërë ditën _____ Në orën _____, verifikimin e kutisë së votimit për zgjedhjet e këshilltarëve-deputetëve, në praninë e votuesit të parë që ka arritur në vendvotim _____
(emri dhe mbiemri)

Rezultati i kontrollit:

(të shënohet se a është kutia e zbrazët)

Votuesi i cili arriti i pari në vendvotim	KËSHILLI I VENDVOTIMIT,
	1. _____
	(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i kryetarit)

(emri dhe mbiemri)

2. _____
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i anëtarit)

(nënshkrimi)
2)

(të shënohen të gjithë anëtarët, si nën pikën

SHËNIM: Fleta e kontrollit, e nënshkruar dhe e vulosur, në prani të votuesit të parë futet në kuti dhe kutia mbyllet me dyll.

PROCESVERBALI
PËR PUNËN E KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT

1. Këshilli i vendvotimit për vendvotimin _____
(emri i vendvotimit dhe numri rendor)

për zgjedhjen e këshilltarëve – deputetëve _____
(emri i komunës)

Është mbledhur më _____ viti, në orën _____, në vendin e caktuar për votime.

2. Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
_____ Ka pranuar _____
(emri i komisionit) (shënohet materiali zgjedhor i pranuar)

3. Në ditën e zgjedhjeve, para fillimi të votimit, Këshilli i vendvotimit ka konstatuar:

- se në vendvotim dhe në distancën prej 100 metra nga vendvotimi nuk ka të vendosura simbole të partive politike dhe material tjetër propagandues që mund të ndikojë në përcaktimin e votuesve;
- se hapësira ku do të votohet është e përgatitur sipas normave për vendvotim dhe se hapësira është përshtatur në mënyrë që votuesit mund të votojnë pa pengesa dhe në mënyrë të fshehtë; që kutia për votim është e rregullt;

që në kutinë për votim është vendosur fletëvotimi.

4. Në orën 7.00, Këshilli i vendvotimit shpall fillimin e votimit në praninë e votuesit të parë.

(emri dhe mbiemri)

Është bërë verifikimi i kutisë së votimit ku është futur lista e kontrollit e nënshkruar dhe kutia është mbyllur dhe vulosur.

5. Votimi ka vijuar në rregullsi të plotë.

Gjatë votimit ka ndodhur _____ (aneksi 1).

(shënohen ngjarjet që kanë ndikuar në ecurinë e votimit, ndërprerjen e votimit dhe vazhdimin e votimit)

6. Në votim marrin pjesë:

1) _____
(emri dhe mbiemri, si dhe në çfarë cilësie merr pjesë)

2) _____
(emri dhe mbiemri, si dhe në çfarë cilësie merr pjesë)

Të shënohen të pranishmit (aneksi 2).

7. _____ Pranimi i kërkesave
për votim me zarf ka përfunduar në orën _____

- Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se janë pranuar _____ kërkesa për votim me zarf,
- Këshilli i vendvotimit ka mundësuar votimin për _____ votues me zarf,
- Këshilli i vendvotimit nuk ka mundësuar _____ votues të votojnë me zarf
për këto shkaqe: _____ (aneksi 3 dhe 4).

8. Votimi është mbyllur në orën _____.

9. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se janë
pranuar gjithsej _____ fletëvotime.
(numri)

10. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se kanë mbetur
_____ fletëvotimi të papërdorura të cilat

11. . Këshilli zgjedhor ka konstatuar se ka _____ fletëvotimi të papërdorura.
(numri)

12. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se ka kupona kontrolli
të ndara nga fletëvotimet dhe fletëvërtetimet _____ (numri)

13. Këshilli zgjedhor e hapen kutinë e votimit.

14. Këshilli zgjedhor konstaton se në kuti

- Gjendet fleta e kontrollit _____
- Nuk gjendet fleta kontrollit _____

15. _____ Këshilli zgjedhor ka konstatuar se ka
_____ fletëvotime të pavlefshme.
(numri)

16. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se ka
_____ fletëvotime të vlefshme. (numri).

17. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar që listat
zgjedhore kanë marrë këtë numër të:

1. _____ votave.

(emri i listës zgjedhore dhe emërtimi i saj i përafërt) (numri)

2. _____ vota.

(emri i listës zgjedhore dhe emërtimi i saj i përafërt) (Numri i votave të shënohet për secilën listë veç e veç)

18. Këshilli zgjedhor ka konstatuar se në Regjistrin e zgjedhësve janë të regjistruar gjithsej _____ votues.

19. _____ Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se në vendvotim kanë votuar _____ votues.
(numri)

20. Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se _____ votues kanë votuar jashtë vendvotimit, gjegjësisht me zarf, (numri)

21. Këshilli i vendvotimit ka konstatuar se kanë votuar gjithsej _____ votues (aneksi 5)

22. Anëtarët e Këshillit të vendvotimit kanë – nuk kanë pasur vërejtje _____
(aneksi 5)

23. _____ Është konkluduar që ky procesverbal bashkë me materialin zgjedhor t'i dorëzohet, pa humbur kohë, Komisionit

24. _____ Komunal të Zgjedhjeve
(emri i komisionit)

Secilit anëtar të Këshillit të vendvotimit i jepet nga një kopje e këtij procesverbali.

Në

(vendi dhe data)

KËSHILLI I VENDVOTIMIT,

1. _____
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i kryetarit)

2, _____
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i anëtarit)
(renditen të gjithë emrat e anëtarëve si nën 2.)

NGJARJET GJATË VOTIMIT

KËSHILLI I VENDVOTIMIT

1. _____
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i kryetarit)

2. _____
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i anëtarit)
(renditen të gjithë emrat e anëtarëve si nën 2)

SHËNIM: Shënohet kur, ku dhe si ka ndodhur ngjarja, pjesëmarrësit e ngjarjes, masat e ndërmarra, të dhënat për votuesin e paaftë fizikisht...

EVIDENCA E VËZHGUESVE TË AKREDITUAR

Emri dhe mbiemri	Numri i akreditimit	Emri i organizatës

KËSHILLI ZGJEDHOR - KRYETARI

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i kryetarit)

KËRKESA PËR VOTIM ME ZARF

Këshillit të vendvotimit për vendvotimin numër _____
(numri-emri i vendvotimit)

Në komunën e _____

Ju njoftoj se për shkak të _____
(jepen/shënohen shkaqet)

Nuk kam mundësi të votoj në vendvotim.

Kërkoj nga Këshilli i vendvotimit që të më mundësojë votimin me zarf, në adresën

Autorizoj _____ nga _____
(emri dhe mbiemri) (emri i komunës)

Numri personal amëzose nr. i letërnjoftimit _____ që në emrin tim, mund t'i dorëzojë Këshillit të vendvotimit, kërkesën time për votim me zarf.

AUTORI I KËRKESËS

(emri dhe mbiemri)

Numri personal amëz _____

Nr. i letërnjoftimit _____

(nënshkrimi)

VËREJTJET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

SHËNIM: Nënshkrimi i anëtarit të Këshillit të vendvotimit është i domosdoshëm.

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins or other markings on the paper.

ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË MAL TË ZI 2016;

EKIPI I AUTORIZUAR PËR VOTIM ME ZARF

Emri dhe mbiemri	Detyra	Nënshkrimi
1.		
2.		
3.		
4.		

Vrojtimet _____

SHËNIM: Në vrojtme të shënohet se a ka vijuar votimi në pajtim me ligjin, a ka pasur vëzhgues të autorizuar (emri dhe mbiemri) etj.


PAJISJET PËR IDENTIFIKIM ELEKTRONIK TË VOTUESVE

(EIB)

UDHËZIMET PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË PAJISJEVE ELEKTRONIKE PËR IDENTIFIKIMIN E VOTUESVE

Përgatitjet për punën me pajisje elektronike për identifikimin e votuesve

Para se të fillojë puna me pajisje elektronike për identifikimin e votuesve duhet të sigurohet furnizimi me energji elektrike dhe sipërfaqja e rrafshtë ku do të vendoset pajisja. Pajisja elektronike për identifikimin e votuesve është e vendosur në kutinë mbrojtëse. Kutia mbrojtëse ka katër mekanizma sigurie, të cilat çelen siç është paraqitur në foton numër 1.



Fotografia numër 1

Pas çeljes së mekanizmave mbrojtës, duhet të hapet kapaku dhe të nxirret nga kutia pajisja elektronike për identifikimin e votuesve.



Pamja e pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve në foton numër 2.



Fotografia numër 2b

Furnizimi i pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve bëhet përmes karikuesit (shenja 2a në foton numër 2) me kabllo drejt pajisjes dhe kabllo për furnizim (shenja 2b në foton numër 2), i cili e sjell rrymën në karikues. Për t'u siguruar se kontakti mes këtyre dy pjesëve të mos jetë i lirshëm, duhet të shtyhet fuqishëm kablloja në karikues, siç shihet në foton numër 3.



Fotografia numër 3

Printeri në kuadër të pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve i cili printon vërtetimin, kyçet duke shtypur butonin e shënuar me shenjen “POWER”, siç shihet në foton numër 4.




Fotografia numër 4

Lexuesi mekanik i tekstit të lexueshëm (në vazhdim: lexuesi) të letërnjoftimeve, gjegjësisht të pasaportave, është pjesë e pajisjes për identifikimin e votuesve, nëpër të cilin përshkohen letërnjoftimi ose pasaporta për të mundësuar leximin në sistem. Për t'u lexuar të dhënat, letërnjoftimi duhet të mbahet ashtu që me gishtin e madh të dorës së djathtë mbulohet stema e Malit të Zi në pjesën e përparme të letërnjoftimit dhe ngadalë, nga lart – poshtë, me shpejtësi konstante, përshkohet letërnjoftimi ose pasaporta nëpër kanal të lexuesit. Përshkrimi i letërnjoftimit nëpër lexues është paraqitur në foton numër 5.



Fotografia numër 5

Ngjashëm veprohet edhe me leximin e pasaportës, siç shihet në foton numër 6.



Fotografia numër 6

Procesi i vendosjes së letres në printer shihet në foton numër 7.



Fotografia numër 7

Procesi i vendosjes së letres në printer bëhet ashtu që në printer shtypet butoni OPEN (siç shihet në foton numër 7) që çel kapakun e printerit dhe në hapësirën e paraparë brenda për letër, vendoset letra siç shihet në foton numër 7.

Udhëzim për punë me aplikacionin për identifikim elektronik të votuesve në vendvotim

3. Aplikacioni për identifikim elektronik të votuesve në vendvotim përbëhet prej këtyre veprimeve:

- Paraqitja në pajisje elektronike për identifikimin e votuesve;
- Identifikimi i votuesit në vendvotim;
- Printimi i të dhënave statistikore;
- Përsëritja e votimit në vendvotim.


1) Paraqitja në pajisje elektronike për identifikimin e votuesve

Sapo të ndizet pajisja elektronike për identifikimin e votuesve, në monitor paraqitet forma (në vazhdim të tekstit: ekrani) që shihet në foton numër 8. Në ekran janë këto informata:

Në majë të ekranit shfaqet emri i vendvotimit, koha dhe data. Në mes të ekranit shfaqet informata se duhet të paraqitet personi i autorizuar në pajisje elektronike për identifikimin e votuesve me ndihmën e eToken-it.



- eToken-i përdoret që, në mënyrë të sigurt, personi i autorizuar të paraqitet në pajisje elektronike për identifikimin e votuesve. eToken-i është çelës elektronik i cili është i kyçur në pajisje elektronike për identifikimin e votuesve në njërën nga dy portat e parashikuara për USB, siç shihet në foton numër 9.



Fotografia numër 9 – Nëse eToken-i nuk mund të kyçet, nuk duhet forcë e madhe, por duhet të kthehet në anën tjetër dhe të tentohet të vendoset në vendkyçje me orientim tjetër, siç shihet në foton numër 10.

Fotoja numër 10 - personi i autorizuar paraqitet në sistem ashtu që e ndez eToken-in në njerën nga dy vendet e lira për pajisje për identifikim elektronik të votuesve, siç shihet në foton numër 9.

Kur në sistem paraqitet personi i autorizuar, shfaqet ekrani për identifikim të votuesve në vendvotim, siç shihet në foton numër 11.

Pa eToken nuk ka mundësi të paraqitesh në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve. Sapo të hiqet eToken-i nga pajisja elektronike për identifikimin e votuesve, përsëri shfaqet ekrani për paraqitje në këtë pajisje.

Fotoja numër 10 - personi i auto

2) Identifikimi i votuesit në vendvotim

Puna në ekranin për identifikimin e votuesve në vendvotim kërkon që njëri nga dy personat e autorizuar të jetë i paraqitur në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve. Nëse nuk ka persona të autorizuar të paraqitur, në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve shfaqet ekrani me paraqitje, siç shihet në foton numër 8. Kur njëri nga dy personat e autorizuar paraqitet, del ekranin e aplikacionit për identifikimin elektronik të votuesve.


Ekranin e aplikacionit për identifikimin elektronik të votuesve, varësisht nga situata gjatë punës, mund të jetë:

- Ekranin fillestar;
- Ekranin e identifikimit të suksesshëm të votuesit;
- Ekranin e votuesit të identifikuar më herët;

- Ekran i identifikimit të suksesshëm të votuesit i cili nuk ka fotografi;
- Ekran i tentimit për identifikim të votuesit i cili nuk gjendet në Regjistrin e zgjedhësve në atë vendvotim;
- Ekran i informacionit për gabimin me rastin e leximit të të dhënave;
- Ekran i informacionit se duhet ndezur printeri.

a) Ekran i fillestar

Menjëherë pas hyrjes në sistem, del ekran i si në foton numër 11. Në ekran janë të dhënat e vendosura në tri zona (në foton numër 11 këto zona janë të rrumbullakësuara me ngjyrë të kuqe):



Fotografia numër 11 – Në majë të ekranit (zona 1) del emri i vendvotimit. Në pjesën e sipërme në të djathtë të ekranit shfaqet data dhe koha.

Nën emrin e vendvotimit paraqitet numri i votuesit në atë regjistr të zgjedhësve për zgjedhjet konkrete dhe statistika e daljes në atë vendvotim (zona 2). Gjatë një dite zgjedhore ka mundësi të ketë votime/zgjedhje të ndryshme: zgjedhje parlamentare, zgjedhje lokale, presidenciale, zgjedhje për komunë urbane ose referendum, dhe këtu dalin të dhënat për secilat zgjedhje/votime veç e veç. Në foton numër 11 janë të dhënat për dy lloj zgjedhjesh/votimesh: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale, të shënuara me ngjyrë të gjelbër.

Numrat e shënuar me ngjyrë të kaltër poshtë secilit lloj të zgjedhjeve tregojnë numrin e votuesve që kanë dalë në zgjedhje dhe numrin e përgjithshëm të votuesve në atë vendvotim. Sipas këtyre numrave, në kllapa paraqitet përqindja e daljes.

Nën statistikën e daljes për atë vendvotim, në pjesën e poshtme gjendet animacioni i cili tregon si përshkohet letërnjoftimi nëpër lexues (zona 3).

b) Ekran i identifikimit të suksesshëm të votuesit

Procesi i identifikimit të votuesit parasheh përshkrimin e letërnjoftimit ose pasaportës së votuesit

nëpër lexues nga ana e personit të autorizuar. Nëse votuesi është gjetur në ekstraktin elektronik të Regjistrit të zgjedhësve për atë vendvotim, në ekran do të paraqitet fotografia e tij dhe të dhënat, siç shihet në fotografinë numër 12.



Fotografia numër 12

- Në fotografinë numër 12 në zonën 1, paraqitet numri rendor i votuesit për zgjedhjet përkatëse. Në zonën 2, paraqiten të dhënat themelore të votuesit: mbiemri, emri, numri personal amëz dhe adresa. Në anën e majtë të ekranit (zona 3) paraqitet fotografia e votuesit. Zona numër 4 paraqet butonin për printim të përsëritur.

Gjatë identifikimit të suksesshëm të votuesit, automatikisht printohet vërtetimi i cili përmban këto të dhëna: mbiemri, emri, numri personal amëz dhe numri rendor i votuesit, i cili është identik me numrin rendor në ekstraktin e printuar të Regjistrit të votuesve. Për çdo lloj të zgjedhjeve printohet vërtetimi. Informacioni se votuesi është identifikuar me sukses vendoset në bazën e të dhënave në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve.

Nëse për ndonjë shkak vërtetimi nuk printohet, ekziston mundësia e printimit duke shtypur butonin për përsëritje të printimit. Përsëritja e printimit është e mundur vetëm nëse votuesi është identifikuar, e nëse jo, duhet të fillojë procesi i identifikimit të votuesit tjetër (nëse në ekran janë të dhënat e votuesit të identifikuar me sukses, por nuk është printuar vërtetimi).

c) Ekran i votuesit i cili është identifikuar më herët

Informacioni se votuesi është identifikuar me sukses hyn në bazën e të dhënave në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve, kështu që aplikacioni nuk lejon përsëritjen e printimit të vërtetimit. Në këtë rast në ekran shfaqen të dhënat për votuesin dhe vërejtja poshtë na anën e majtë, se ky votues ka qenë i identifikuar më herët. Në këtë rast nuk është i mundur printimi i vërtetimit, siç shihet në fotografinë numër 13.



Fotografia numër 13

d) Ekran i identifikimit me sukses të votuesit i cili nuk ka fotografi

Nëse ndodh që votuesi i cili gjendet në Regjistrin e votuesve, por nuk e ka fotografinë në ekstraktin elektronik të Regjistrit, në këtë rast votuesi do të identifikohet dhe atij do t'i printohet vërtetimi. Sistemi vetëm nuk do të paraqesë fotografinë e tij, siç shihet në fotografinë numër 14. Situata kur votuesi nuk ka fotografi në ekstraktin elektronik të Regjistrit të votuesve, mund të ndodhë në rastin kur votuesi ka parashtruar kërkesën për letërnjoftim ose pasaportë pas mbylljes së Regjistrit të votuesve.



Fotografia numër 14

e) Ekran i tentimit të identifikimit të votuesit i cili nuk gjendet në Regjistrin e zgjedhësve në atë vendvotim.

Për votuesin, të cilit janë lexuar të dhënat me sukses, por nuk është gjetur në Regjistrin e zgjedhësve për atë vendvotim, del informacioni siç shihet në fotografinë numër 15.



Fotografija numër 15

f) Ekran i informacionit për gabim gjatë leximit të të dhënave

Nëse në rastin e leximit të letërnjoftimit ose pasaportës paraqitet gabimi, për shkak të tërheqjes tepër shpejt ose tepër ngadalë, lëvizjes/këndit të gabuar të dokumentit ose papastërtisë së tij, aplikimi për identifikimin e votuesve në vendvotim e zbulon këtë gabim dhe ia paraqet personit të autorizuar në formën e mesazhit në pjesën e poshtme, në të djathtë të ekranit, siç shihet në fotografinë numër 16.



Fotografija numër 16

g) Ekran i informacionit për nevojën e kyçjes së printerit

Për nevojën e printimit të vërtetimit gjatë identifikimit të votuesit në vendvotim, duhet që printeri si pjesë e pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve të jetë i kyçur. Nëse printeri nuk është i kyçur, poshtë në anën e djathtë do të paraqitet statusi i vërejtjes, siç shihet në fotografinë numër 17. Pa kyçjen e printerit nuk është e mundur të vazhdohet puna.



Fotografija numër 17

3) Printimi i të dhënave statistikore

Pas përfundimit të orarit të paraparë për votim (ora 20), në ekran do të shfaqet butoni “Statistika”.



Fotografija numër 18

Ky opsion shërben që pas përfundimit të votimit mund të printohet raporti i statistikës, i cili përmban këto të dhëna: vendvotimi, data dhe koha e printimit, numri i votuesve në vendvotim sipas llojit të votimit, numri i votuesve të identifikuar, numri i votuesve për të cilët është tentuar përsëritja e identifikimit, numri i votuesve për të cilët është tentuar identifikimi, por nuk gjenden në ekstraktin e Regjistrin të zgjedhësve për atë vendvotim. Opsioni “statistika” mund të vihet në veprim vetëm pas kalimit të kohës së paraparë për votim dhe nëse në pajisjen elektronike për identifikimin e votuesve janë të kyçur të dy eTokena-t.

Në bazë të nenit 32 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve (“Fl. zyrtare e RMZ”, nr. 4/98, 17/98, 14/00, 9/01, 41/02, 46/02, 48/06 i 56/06) dhe Strategjisë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për periudhën 2010-2014, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2010, nxori

KODIN ETIK TË ORGANEVE PËR REALIZIMIN E ZGJEDHJEVE

(“Fl. Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 76/10, datë 23. 12. 2010)

Qëllimi dhe përmbajtja

Neni 1

Kodi etik (në vazhdim: Kodi) përmban parimet, standardet dhe normat e sjelljes së anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe këshillave të vendvotimeve (në vazhdim: organeve për realizimin e zgjedhjeve në Mal të Zi), veçanërisht gjatë procesit zgjedhor.

Neni 2

Qëllimi i Kodit është promovimi i rolit dhe reputacionit të organeve për realizimin e zgjedhjeve në kryerjen e punëve në kuadër të kompetencave të tyre.

Kodi përmban normat mbi parimet, standardet dhe rregullat e sjelljeve, obligimet lidhur me njoftimin për përmbajtjen e Kodit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit.

Rregullat e Kodit kanë të bëjnë me të gjithë anëtarët e organeve për realizimin e zgjedhjeve që parashihen me Ligjin për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, e këto janë:

- Kryetari, anëtarët e emëruar, anëtarët e autorizuar, zëvendësit e kryetarëve dhe anëtarëve të zgjedhur dhe të autorizuar dhe sekretari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- kryetarët, anëtarët e emëruar, anëtarët e autorizuar, zëvendësit e kryetarëve dhe anëtarëve të zgjedhur dhe të autorizuar dhe sekretarët e komisioneve komunale të zgjedhjeve në Mal të Zi;
- kryetarët, anëtarët e emëruar, anëtarët e autorizuar, dhe zëvendësit e kryetarit, anëtarëve të emëruar dhe autorizuar të këshillave të vendvotimeve në Mal të Zi.

II. PARIMET E KODIT

Obligimet e anëtarëve për realizimin e zgjedhjeve

Neni 3

Për realizimin e parimeve të Kodit, të gjithë anëtarët e organeve për realizimin e zgjedhjeve kanë për detyrë të sillen sipas rregullave të këtij Kodi, të ndërmarrin disa veprime dhe masa, gjegjësisht të përmbahen nga veprimet e ndaluara.

Përveç obligimeve që burojnë nga ligji dhe akteve tjera nënligjore, anëtarët e organeve për realizimin e zgjedhjeve, kanë pëe detyrë:

1. T’i përmbushin obligimet e veta me ndërgjegje, profesionalizëm dhe përgjegjësi;
2. Punët t’i kryejnë me ndershmëri, efikasitet dhe sipas standardeve profesionale;
3. Të ruajnë reputacionin e organit që përfaqësojnë;

4. Me qytetarët të sillen me durim, mirësjellje dhe me respekt gjatë realizimit të të drejtave të tyre gjatë ditës së votimit dhe të respektojnë personalitetin e tyre, dinjitetin dhe të drejtat e barabarta;
5. Të jenë të azhurnuar, profesionistë dhe të saktë në plotësimin e obligimeve ligjore;
6. Me pamje dhe veshje të përshtatshme;
7. Të zhvillojnë marrëdhënie kolegiale dhe korrekte ndaj anëtarëve të tjerë të organeve për realizimin e zgjedhjeve.

Anëtarët e organeve për realizimin e zgjedhjeve duhet të sillen si nikoqirë të mirë, të kenë parasysh efikasitetin dhe ekonimizimin në përdorimin e mjeteve materiale dhe financiare që u janë besuar atyre për kryerjen e detyrave, si dhe të parandalojnë përdorimin e tyre të paligjshëm.

Ndalesat

Neni 4

Anëtarët e organeve për realizimin e zgjedhjeve nuk e kanë të lejuar:

1. Të përdorin pronën e organeve për realizimin e zgjedhjeve për çështje private;
2. Të favorizojnë ndonjë kategori të qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre për shkak të përkatësisë së tyre politike, nacionale, racore, fetare, gjinore ose tjetër;
3. Të japin deklarata ose informata që e dëmtojnë reputacionin e organit për realizimin e zgjedhjeve gjatë procesit zgjedhor;
4. Të keqpërdorin pozitën në organet për realizimin e zgjedhjeve për dobi personale ose në dobi të partisë politike e cila e ka deleguar si anëtar;
5. T'i shkaktojë dëm organeve për realizimin e zgjedhjeve me qëllim ose nga neglizhenca, ose të nxisë të tjerët për këtë;
6. Në lokalet zyrtare dhe në vendvotim të sjellin ose të posedojnë dhe përdorin lëndë të ndaluara (siç është alkooli, droga etj.).

III. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË KODIT

Neni 5

Mbikqyrjen e zbatimit të këtij kodi e ushtron Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Malit të Zi.

Kryetari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i Malit të Zi ka të drejtë të nisë procedurën, para organeve kompetente për emërimin, shkarkimin e anëtarit përgjegjës për realizimin e zgjedhjeve nëse veprimet e tij nuk janë në pajtueshmëri me parimet bazë dhe normat e këtij kodi.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 6

Të gjitha shprehjet që në këtë Kodeks përdoren për personat fizikë të gjinisë mashkullore përfshijnë shprehjet e njëjta për personat fizikë të gjinisë femërore.

Neni 7

Ky kodeks do të publikohet në “Fl. Zyrtare të Malit të Zi”.

Përkrahur nga:



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Montenegro

Financuar nga:



Britanska ambasada
Podgorica



*Ambasciata d'Italia
Podgorica*



Ambasada
Savezne Republike Njemačke
Podgorica